

KËRKESË
Nr.6319/1, datë 24.12.2008

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i “Pikës së grumbullimit të mbeturinave të BajramCurrit”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia e Bajram Curri. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 530 000 (katër milionë e pesëqind e tridhjetë mijë) lekësh.

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË “PIKËS SË GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE
B.CURRI”

NR.	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	NR.PRONËSISË	ZONA KAD.	LLOJI I PAS.	ÇMIMI	SIPËRFAQE	VLERA TOTALE	SHËNIME
1.	ERENIK	ZENUN	GJYRIQI	1/18	1347	TOKË BUJQËSORE (VRESHTË)	302 LEKË/M ²	12 000 M ²	3 624 000 LEKË	PROCES GJYQËSOR
2.	ADULLAH	ADEM	GJYRIQI	1/16	1347	TOKË BUJQËSORE (VRESHTË)	302 LEKË/M ²	3 000 M ²	906 000 LEKË	PROCES GJYQËSOR
3.	SHUMA							15 000 M ²	4 530 000	